



Prishtinë: 02.09.2021

Kodi i ZRRE-së: V_1380_2021

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 9, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.7, nenin 15 dhe 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK_V_2158_04_21** të dt. 14.04.2021;
- Ankesën e konsumatorit të dt. 02.06.2021;

në seancën e mbajtur më datë **02.09.2021** nxori këtë:

V E N D I M

- I. **REFUZOHET** ankesa e konsumatorit B.M nga Komuna e Prishtinës, si e pabazuar.
- II. **MBETET në fuqi**, vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRrE, me nr. ZRrE/DMK_V_2158_04_21, i datës 14.04.2021.

A r s y e t i m

Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorëve me datë 14.04.2021 ka marrë vendim me nr. ZRrE/DMK_V_2158_04_21 me të cilin e ka refuzuar ankesën e konsumatorit B.M nga Komuna e Prishtinës dhe e ka obliguar KESCO-n që konsumatorit t'i ofroj marrëveshje pagese me këste për një periudhë nëntë (9) mujore, lidhur me kontestimin e faturës nr.0215180017DPR – 14861 të datës 26.02.2015.

I pakënaqur me Vendimin e DMK-së, konsumatori B.M, brenda afatit ligjor ka parashtruar ankesë në Bordin e ZRrE-së për këto shkaqe:

- Vendimi i DMK-së është i kundërligjshëm, andaj e kërkon anulimin e tij, pasi që mënyra se si është bërë verifikimi dhe faturimi i borxhit është i kundërligjshëm.
- Ligjin për Metrologjinë thuhet se “Verifikimi i jashtëzakonshëm i mjeteve matëse dhe kontrolli i matjeve zyrtare bëhet me ekspertizë metrologjike, kur ka dyshime për keqfunksionimin e mjeteve matëse ligjore”.
- Punëtorët e KEDS-it kanë vepruar në kundërshtim me këtë dispozitë ligjore, pasi që të njëjtin nuk kanë bërë analizë metrologjike.
- Kërkon anulimin e Vendimit të DMK-së dhe anulimin e faturës së datës 26.02.2015.

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji në mbledhjen e mbajtur me datë 02.09.2021 ka analizuar të gjitha shkresat e lëndës të prezantuara nga palët në kontest, si dhe vendimin e Departamentit për



Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe pas kësaj ka vërtetuar se vendimi i DMK-së si vendim i shkallës së parë është vendim i drejtë dhe i bazuar në prova konkrete.

Lidhur me pretendimin e konsumatorit se mënyra se si është bërë verifikimi dhe faturimi i borxhit është i kundërligjshëm, Bordi si të tillë e vlerëson të paqëndrueshëm, sepse analizimi i rrjedhës së energjisë elektrike dhe krahasimi i shpenzimit të energjisë elektrike me periudhat para dhe pas kontestit, krahas administrimit të të gjitha shkresave të tjera, përbën një nga provat më të rëndësishme në procesin e zgjidhjes së ankesave të konsumatorëve në sektorin e energjisë, pasi që në këtë mënyrë, ne mund të analizojmë profilin e një konsumatori dhe shpenzimin e tij ndër vite.

Pra, në mënyrë që të kemi një pasqyrë sa më të qartë të konsumit të energjisë elektrike, kemi analizuar krahasimin e shpenzimeve para dhe pas periudhës kontestuese, në dy njehsorët elektrik njehsorin nr.34726036, si dhe njehsorin i ri elektrik nr.63980547. Sipas rrjedhës së energjisë elektrike shpenzimet e konsumatorit për periudhat e mëhershme me njehsorin e vjetër elektrik nr.34726036:

- periudha 02/2012 është **3,005 kWh**,
- periudha 02/2013 është **2,945 kWh**,
- periudha 02/2014 është **2,187 kWh**,
- periudha 02/2015 është **24,378 kWh**,

ndërsa shpenzimet e konsumatorit për periudhat e mëvonshme me njehsorin e ri elektrik nr.63980547 janë:

- periudha 02/2016 është **2,877 kWh**,
- periudha 02/2017 është **3,060 kWh**,
- periudha 02/2018 është **1,292 kWh**,
- periudha 02/2019 është **1,354 kWh**,
- periudha 02/2020 është **1,248 kWh**.

Nga rrjedha e energjisë elektrike shihet se mesatarja mujore e shpenzimit të energjisë elektrike e konsumatorit sipas viteve ka qenë: 2012 – **1,713.08 kWh/muaj**; 2013 – **2,139 kWh/muaj**; 2014 – **749.91 kWh/muaj**; 2015 – **3,853.67 kWh/muaj** (përfshi edhe periudhën kontestuese); 2016 – **2,236.64 kWh/muaj**; 2017 – **1,725.75 kWh/muaj**; 2018 – **879.00 kWh/muaj**, 2019 – **927.41 kWh/muaj**, 2020 – **999.91 kWh/muaj**.

Për më tepër, nga shkresat e lëndës Bordi ka gjetur se konsumatori nga periudha 05/2014 – 01/2015 nuk ka pasur shpenzim të energjisë elektrike të faturuar, por është ngarkuar vetëm me taksa fikse, dhe në muajin 02/2015 konsumatori është ngarkuar me shpenzim prej TL = 24378 kWh dhe TU = 00000 kWh, andaj, për shkak të mos faturimit të kësaj periudhe – korrigjimi financiar nr.73112DPR – 14861 i bërë nga KESCO me datë 14.03.2015 për konsumatorin në vlerë prej -670.38 euro është i saktë dhe në përputhje me nenin 28, par. 3 të Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji, Bordi konstaton se nuk ka elemente tjera të korrigjimit financiar.



Lidhur me pretendimin se nuk është bërë analizë metrologjike, Bordi thekson se ky pretendim si i tillë nuk qëndron, për faktin se punëtorët e autorizuar të Qendrës së Kalibrimit, me datë 27.02.2015 kanë bërë kontrollimin e njehsorit elektrik nr. 34726036 dhe në Procesverbalin e kontrollimit të njehsorit elektrik nr.org.02, kanë konstatuar se: njehsori elektrik bllobat i ka në rregull, nga ana e jashtme dëmtime të tjera nuk ka, në brendi të njehsorit komisioni nuk ka vërejtur ndonjë parregullsi.

Korrigjimi i KESCO bërë konsumatorit është i saktë dhe është në përputhje të plotë me nenin 28, paragrafi 3 i Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji, në të cilën theksohet se: *“Në rast të gabimeve që rrjedhin prej të dhënave të leximit të pasaktë të njehsorit, të cilat shkaktojnë faturim të pasaktë, Furnizuesi do të bëjë të gjitha korrigjimet (rregullimet) e nevojshme në faturën vijuese”* dhe se gjatë analizimit të korrigjimit të lartcekur, kemi vërtetuar se mesatarja e shpenzimit të energjisë elektrike pas shpërndarjes proporcionale nga periudha 05/2014 – 01/2015 rezulton të jetë 2,708.67 kWh/muaj e që përputhet me shpenzimin e energjisë elektrike të periudhave të mëhershme me njehsorin elektrik nr.34726036.

Andaj, për shkak të mos faturimit të shpenzimit prej 24,378 kWh për muaj të tërë (periudha 05/2014 – 01/2015), e më pastaj faturimit të saj për një muaj, si dhe pas ankesës së konsumatorit që ka rezultuar me korrigjim financiar, Bordi pajtohet me konstatimin e DMK-së se KESCO duhet që konsumatorit t’i ofroj marrëveshje pagese me këste për një periudhë nëntë (9) mujore.

Nën dritën e këtyre fakteve: se nga qendra e kalibrimit është konstatuar se njehsori është në rregull dhe se nuk ka dëmtime në brendi, se nga krahasimi i shpenzimeve ka rezultuar se mesatarja e shpenzimit të energjisë elektrike është e përafërt me shpenzimin e kalkuluar sipas korrigjimit të KESCO-s dhe se për muaj të tërë konsumatori nuk është faturuar me faturë të rregullt, Bordi thekson se shpenzimi i faturuar si i tillë është bërë/realizuar nga konsumatori dhe se i njëjti obligohet që të paguajë sipas marrëveshjes që do t’i ofrohet nga KESCO.

Në nenin 25, paragrafi 1 të Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji, është theksuar se: *“konsumatori është i obliguar që të ju lejojë qasje në pronën e tij, përfaqësuesve të Operatorit të Sistemit/Furnizuesit, për qëllim të leximit, testimit, inspektimit, instalimit, mirëmbajtjes, riparimit të matësve, kyçjeve dhe pajisjeve përkatëse ashtu si paraqitet në Nenet 28, 29 dhe 30 të Ligjit për Energji”*.

Bordi i ZRRE, gjithashtu ka konstatuar se konsumatori në ankesën e tij nuk ka ofruar asnjë provë bindëse për të vërtetuar faktin se vendimi i DMK-së si organ i shkallës së parë nuk është vendim i drejtë dhe i bazuar në ligje dhe rregulla, por që i njëjti në ankesë vetëm se ka kontestuar vendimin e shkallës së parë në mënyrë të përgjithësuar pa ofruar prova të arsyeshme.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 00.09.2021 pas analizimit të gjithë asaj që u theksua më lartë, ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

III. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.

IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.



Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Vendimi iu dërgohet:

- KESCO-së,
- Konsumatorit B.M. dhe,
- Arkivit të ZRRE-së

Bordi i ZRRE-së:

Ymer Fejzullahu, Kryesues

Selman Hoti, anëtar

Izet Rushiti, anëtar

Lutfije Dervishi, anëtare

Gani Buçaj, anëtar